

## **Ne fokus/ Dalin ne shitje biletat per derbin Partizani – Tirana**

nga AlbaniaSoccer  
E enjte, 10 Tetor 2013 14:29

---



Kane dale ne shitje ashtu si Partizani kishte premtuar biletat per ndeshjen derbi qe te gjithe presin. Te enjten ne mengjes, ne dy pikat e percaktuara, ka nisur shitja e biletave per ndeshjen mes Partizanit dhe Tiranes qe do te luhet te shtunen ne oren 20:00. Njera pike gjendet tek biletaria e stadiumit Qemal Stafa ndersa tjetra prane pallateve qe ne Tirane njihen si nente kateshet. Biletat ne tribunat kryesore do te kushtojne 500 leke ndersa ne ate karshi 300 leke. Interesimi ne oret e para ka qene shume i madh dhe pritet qe stadiumi te jete i mbushur plot.